



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 2341 Prot.

Shkodër me 31.03 2026

V E N D I M

Nr. 13, datë 27.03.2026

PROPOZIM PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Znj. Violetë Selim Puka (Paçrami)

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 27.03.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin mbi projekt vendimin “Propozimin për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror”, të përgatitur nga administrata dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”; si dhe kërkesën e subjektit,

pasi u kalua në proces votimi të fshehtë nga anëtarët e Këshillit të Qarkut, **ku u miratua me: 15 vota Pro, 0 vota Kundër dhe 0 vota Absenim;**

V E N D O S I:

I. T’i propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror për:

Znj. Violetë Selim Puka (Paçrami)

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr.139/2015



(Handwritten signature)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 230/2 Prot.

Shkodër me 30.03 2026

RELACION

PËR PROJEKT -VENDIMIN

PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 27.03.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin mbi projekt vendimin “Për propozimin për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror”, të përgatitur nga administrata dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” me ndryshimet përkatëse, pensioni i posaçëm shtetëror apo shtesa e pensionit të posaçëm shtetëror u takon: **b) Personave që kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës.**

Në përputhje me dispozitat ligjore të mësipërme, akteve nënligjore dalë në zbatim të tyre si dhe në kërkesën e depozituar pranë Këshillit të Qarkut Shkodër, paraqesim këtë relacion për shqyrtim të mëtejshëm, propozim për dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror, për:

Znj. Violetë Selim Puka (Paçrami)

- lindur në Shkodër 12.06.1959
- përfiton pension mujor pleqërie prej 41288 (*Dyzet e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë*) lekë që nga dt. 15.07.2020.
- Çertifikatë - Për punën dhe përkushtimin e treguar në krijimin dhe debutimin e bandës “The Door”, lëshuar nga donatorët KIWAINS Albania AID, (Presidenti z. Falk Bakke) në vitin 2005.
- Çertifikatë - Për punën e palodhur me nxënësit me aftësi të kufizuar, lëshuar nga Drejtoria e Shkollës Speciale “3 Dhjetori” - Shkodër.
- Çertifikatë “Mirënjohjeje Publike” - Për kontributin e vyer gjatë gjithë përvojës profesionale si mësuese në arsimimin e brezave dhe kultivimin e qytetarëve të denjë të vendit, lëshuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Janar-2021.
- “Mirënjohje” - Për kontributin e saj të madh në ndihmë të personave me aftësi të kufizuar në territorin e qytetit të Shodrës-Shqipëri, lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër më 05.10.2010.
- “Mirënjohje”- Për kontribut të gjatë e të suksesshëm në realizimin e Festivalit Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë, aktivitetit më të rëndësishëm në planin mbarë-shqiptar me këtë moshë, lëshuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër. Korrik-2012.

Duke shpresuar në miratimin nga ana Juaj,



KRYETARI
Edmond NDOU